



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the
General Secretary

Nr. 5 /2026

Datë: 09 / 01 /2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (GZ, nr. 7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 8 të Rregullores Nr.08/2023 për Shtesat e të punësuarve në Sektorin Publik, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për kryerjen e punëve shtesë në Divizionin e Prokurimit të Ministrisë së Drejtësisë.

1. z. Gëzim Mustafaj, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ngarkohet të kryej edhe punë shtesë në Divizionin e Prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë nga data 01.01.2026 deri 31.05.2026.
2. Zyrtari nga pika 1 e këtij vendimi, për punën shtesë të ngarkuar në Divizionin e Prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë, kompensohet në vlerën shtesë për vëllim të punës deri në njëzet përqind (20%) të pagës bazë të nëpunësit civil në përputhje me nenin 8 dhe paragrafin 6 të nenit 9 të Rregullores (QRK) nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.
3. Zyrtari i angazhuar për punë shtesë nga pika 1 e këtij vendimi nuk duhet të paraqet konflikt interesi mes pozitës së vet dhe pozitës që e zëvendëson.
4. Obligohen njësitë përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Anita Kalanderi

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i dërgohet:

- Z. Gëzim Mustafaj;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore dhe
- Arkivit të MD-së.